


ENERGJIA PAS ZGJEDHJEVE TË 7 QERSHORIT 2026: ÇKA PO OFROJNË PARTITË POLITIKE?



SHËNIM METODOLOGJIK

Kjo Qarkore nuk është vlerësim elektoral dhe nuk synon të krahasojë partitë politike mbi bazën e preferencave politike. Qëllimi është t'i lexojë zotimet publike kundrejt Strategjisë së Energjisë 2022 – 2031, draft-NECP-it, detyrimeve të Komunitetit të Energjisë dhe presioneve që burojnë nga CBAM-i.

Baza dokumentare nuk është e njëjtë për të gjitha subjektet politike. Ky dallim është i rëndësishëm për të shmangur një krahasim mekanik. Aty ku ka zotime të detajuara, Qarkorja analizon përputhjen e tyre me politikën në fuqi (sidomos për VV-në si partia që ka hartuar dhe miratuar zotimet kyçe në fuqi). Aty ku ka vetëm orientime të përgjithshme ose programe të mëparshme, Qarkorja vlerëson drejtimin politik, mungesën e detajeve dhe çështjet që do të duhej të sqaroheshin para se ato të përkthehen në vendimmarrje qeveritare.

BAZA DOKUMENTARE E KRAHASIMIT

- Zotimet e VV-së, 7 qershor 2026
- Programi i PDK-së, dhjetor 2025
- Qëndrimet publike të LDK-së
- Programi/qëndrimet e AAK-së
- ZRRE Raporti Vjetor 2025

Premtimi politik duhet të matet kundrejt realitetit të sistemit.

Zgjedhjet e 7 qershorit 2026 e gjejnë sektorin e energjisë në një moment ku premtimet politike nuk mund të lexohen më vetëm si deklaratime zhvillimore. Ato duhet të maten kundrejt realitetit të sistemit elektroenergjetik, kostos së furnizimit, nevojës për mbrojtje të konsumatorëve dhe detyrimeve që Kosova tashmë i ka marrë në kuadër të Strategjisë së Energjisë, draft-Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë, Komunitetit të Energjisë dhe procesit të integritimit në tregun evropian. Në thelb, partitë kryesore politike e njohin energjinë si çështje strategjike. Dallimet paraqiten në rrugën që propozojnë: disa e theksojnë rehabilitimin e kapaciteteve ekzistuese, disa kapacitete të reja me linjit, disa gazin si burim tranzitor, disa burimet e ripërtëritshme, ndërsa disa masat sociale për uljen e faturave. Megjithatë, asnjë ofertë politike nuk e mbyll plotësisht trekëndëshin që Kosova duhet ta zgjidhë në mandatin e ardhshëm: siguri furnizimi, përballeshmëri sociale dhe përputhje me detyrimet klimatike e tregtare evropiane.

PYETJA E DUHUR

Jo "kush premtion më shumë megavat" — por cilat kapacitete janë teknikisht të nevojshme, financiarisht të përballeshme, klimatikisht të pajtueshme dhe socialisht të drejta.

Sipas Raportit Vjetor të ZRRE-së për vitin 2025:

5,298

GWh

Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike:

- 4,687 GWh nga termocentralet
- 611.5 GWh nga hidro & BRE.

6,944

GWh

Kërkesa e përgjithshme në sistem (rritje prej 5.04% krahasuar me vitin 2024)

16.1%

rritje e tarifave e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar. Çmimi mesatar për konsumatorët familjarë ishte 8.17 eurocent/kWh pa TVSH, ndërsa për konsumatorët jofamiljarë 10.46 eurocent/kWh.[1] Kjo e vendos përbalueshmërinë në qendër të debatit.

HUMBJET NË SHPËRNDARJE

995 GWh ose
15.05% ndaj
kërkesës në
shpërndarje

HUMBJET PJESA NDAJ KËRKESËS

Kjo sasi është afërsisht e krahasueshme me prodhimin vjetor të një kapaciteti të madh energjetik dhe tregon se siguria e furnizimit nuk zgjidhet vetëm me megavat të rinj, por edhe me ulje të humbjeve dhe përmirësim të performancës së rrjetit.

BILANCI I FURNIZIMIT 2025

PRODHIMI VENDOR 5,298 GWH

IMPORTI 1,965 GWH

EKSPORTI 377 GWH

INTEGRIMI TREGTAR

ZRRE raporton se gjatë vitit 2025 ka vazhduar liberalizimi i tregut, me 8 furnizues aktivë në një periudhë gjashtëmujore, ndërsa Kosova ka avancuar në mekanizmat për Garancitë e Origjinës dhe reformimin e mekanizmit mbështetës për burimet e ripërtëritshme. Këto zhvillime tregojnë se vendi po hyn në një cikël të ri tregu, ku energjia lidhet gjithnjë e më shumë me konkurrueshmërinë, karbonin dhe integrimin.

Çdo vendim për kapacitete të reja, rehabilitim, import, rrjet ose subvencione duhet të vlerësohet në fund mbi pyetjen: kush e paguandhe si mbrohetkonsumatori i cenueshëm?



Vazhdimësi me disa shtylla strategjike — por instrumentet duhen sqaruar.

Programie vendos energjinënë kuadër të përbalueshmërisë së çmimeve, pavarësisë energjetike dhe ndikimit në shëndet. Parashihen investime në kapacitete bazuar në burime vendore, sisteme të ngrohjes qendrore, efijencë, modernizim të sistemit dhe integrim rajonal e evropian i tregut.

Në sigurinë e furnizimit, VV parasheh vazhdimin e investimeve në TC Kosova A dhe Kosova B — rritje kapaciteti për së paku 20% në Kosova B, ulje të pluhurit për 97% dhe oksideve të azotit për 75%, si dhe rehabilitim të thellë të Kosova A me rritje të kapacitetit prodhues për 60%.

Në BRE, VV premtion rritje më shumë se trefish të kapaciteteve: së paku 305 MW erë dhe 250 MW solare nga projekte të nisura, me synim që 20% e energjisë së konsumuar të vijë nga burime të pastra dhe Kosova të bëhet neto eksportuese.

PJESA MË E FORTË E PROGRAMIT

Pjesa kryesore e programit fokusohet në lidhjen mes ngrohjes qendrore, efijencës së energjisë dhe uljes së konsumit të energjisë elektrike gjatë dimrit. Programi parasheh zgjerimin e ngrohjes qendrore, projekte solare termike dhe investim prej 150 milionë eurosh për masa të efijencës, përfshirë mbështetje për familjet dhe renovimin e ndërtesave publike. Paralelisht, nga vitet 2021–2023 janë zhvilluar studime të fizibilitetit për sisteme të ngrohjes qendrore në Obiliq, Mitrovicë, Zveçan, Pejë, Gjilan, Prizren dhe Drenas, me fokus në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme si energjia solare, biomasa, nxehtësia gjeotermale, biogazi dhe kogjenerimi.

ÇKA MUNGON

Qartësi në instrumentet e zbatimit: si do të vendoset ose simulohet çmimi i karbonit; si mbrohen konsumatorët e cenueshëm; si përgatitet sistemi për CBAM-in; si financohen investimet; dhe si koordinohet rritja e BRE-ve me rrjetin e rezervat.

PREMTIM VS. REALITET

Solare —
premtim

250 MW (nga projekte të nisura)

Solare —
gjendja ZRRE

275 MW në ndërtim;
+17.6 MW në shqyrtim;
21.5 MW në operim
(2025)

Erë —
premtim

305 MW

Erë —
gjendja ZRRE

- 70 MW në ndërtim (Wind Park Zatic 1 & 2, secili nga 35 MW);
- ERA Wind Park Kitka 2 (33 MW) në shqyrtim
- Përcaktimi i çmimit maksimal
- për ankandin e erës prej 100MW në nivelin 80.2 EUR/MWh

Në përputhje me Strategjinë

Koment: Zotimet për BRE, efijencë, ngrohje qendrore dhe modernizim të kapaciteteve ekzistuese kanë vazhdimësi me Strategjinë e Energjisë, e cila synon rritje të BRE-ve, ulje të emetimeve dhe modernizim të sistemit.

Pika që kërkojnë sqarim

Programi nuk e vendos mjaftueshëm qartë çmimin e karbonit, CBAM-in, tregun balancues, mbrojtjen e konsumatorëve gjatë liberalizimit dhe regjimin e varfërisë energjetike. Këto janë elemente thelbësore të zbatimit të strategjisë, jo çështje dytësore.

Pika potencialisht problematike

Zotimi për gazifikim të qymyrit kërkon vlerësim të posaçëm teknik, financiar dhe klimatik. Pa analizë të kostos, emetimeve, teknologjisë dhe përputhshmërisë me CBAM-in, ky drejtim mbetet i paqartë në raport me objektivat e dekarbonizimit.



Dimension social i artikulluar — por rikthim të linjtit pa kosto karboni.

POZITIVE

Në materialet e disponueshme, PDK e trajton energjinë si prioritet kombëtar me objektiv sigurinë e furnizimit, uljen e koston për qytetarët dhe diversifikimin e burimeve. Programi nis me heqje të TVSH-së, mekanizma për konsumatorët e ndjeshëm, subvencionim të konsumit bazë, tarifa mbrojtëse sociale dhe politika kundër shkyçjes për arsye sociale.

Në një vit kur tarifrat janë rritur dhe importi mbetet komponent i rëndësishëm, mbrojtja e konsumatorëve të ndjeshëm është e domosdoshme.

PËRPARËSIA

Artikulli i nevojës për kapacitet bazë dhe njohja e dimensionit social të faturës.

PIKAT E DOBËTA

Ndërtimi i Termocentralit "KOSOVA E RE" me kapacitet

~500 MW

plus minierë të re linjiti për furnizim afatgjatë dhe revitalizimin e Kosova B për së paku 25 vjet.

PYETJE PA PËRGGJIGJE

- Si shmangen penalitetet e Komunitetit të Energjisë?
- Si llogaritet CBAM-i mbi linjtin e ri?
- Si mbrohet konsumatori nga kostoja kapitale?
- Si përputhet me Agjendën e Gjellbër?
- Si menaxhohet rreziku i aseteve të bllokuara?
- Afati real i ndërtimit?

HEQJA E TVSH-SË — EFEKTIVE POR HORIZONTALE



Ndihmon në afat të shkurtër, por përfiton njësoj edhe familjet me të ardhura më të larta dhe konsum më të madh. Politika më e drejtë: kombinim i mbështetjes për konsum bazik, regjistër të konsumatorëve të cenueshëm, efikasitet në banesa dhe mbrojtje kundër shkyçjes për familjet në nevojë.



Arkitekturë më e qartë teknologjike — por gazi kërkon fizibilitet të plotë.

Programi energjetik i LDK-së e trajton sektorin si çështje të sigurisë kombëtare, stabilitetit ekonomik dhe zhvillimit strategjik. Ai propozon tranzicion të balancuar përmes kombinimit të burimeve të ripërtëritshme, gazifikimit, eficiencës dhe liberalizimit të tregut. Projekti kryesor është ndërtimi i një centrali me gaz prej 500 MW, me vlerë të deklaruar rreth 500 milionë euro dhe me partneritet amerikan. Programi parasheh po ashtu gazifikimin e Kosovës përmes linjës Hani i Elezit-Mitrovicë, me vlerë rreth 100 milionë euro, dhe lidhje me rrjetet rajonale përmes Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë. LDK propozon gjithashtu rehabilitimin e Kosova B, me synim zgjatjen e jetëgjatësisë për 20–25 vjet dhe rritjen e kapacitetit efektiv deri në 560 MW. Në burime të ripërtëritshme, programi parasheh 500 MW energji solare dhe 500 MW energji nga era, zhvillimin e prosumerëve, masa të eficiencës për ulje të konsumit deri në 30%, sisteme baterish, hidrocentrale të vogla, infrastrukturë rezervë dhe mobilitet elektrik. Në anën sociale, LDK propozon heqjen e TVSH-së në energji për familjarët si masë për uljen e menjëhershme të faturave. Kjo mund të ketë efekt të shpejtë, por mbetet masë horizontale.

Pjesa pozitive e programit është se ka arkitekturë më të qartë teknologjike se ofertat e përgjithshme: gaz si kapacitet fleksibil, BRE si diversifikim, eficiencë si ulje e kërkesës dhe bateri si element stabilizues. Kjo e bën programin më të lexueshëm nga pikëpamja e planifikimit të sistemit.

Pjesa më problematike lidhet me gazin, i cili nuk është vetëm zgjedhje teknologjike, por edhe çështje rajonale, infrastrukturore dhe gjeopolitike. Për ndërtimin e një centrali me gaz duhet të qartësohen furnizimi, çmimet afatgjata, financimi, ndikimi në tarifa dhe rreziku i krijimit të një varësie të re nga importi. Pa këto analiza, gazi mund të zvogëlojë një rrezik energjetik, por të rrisë ekspozimin ndaj çmimeve ndërkombëtare të karburanteve fosile.

ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS



Diagnozë e saktë — por ofertë më pak e detajuar.

SAKTËSIA E DIAGNOZËS

Programi i AAK-së e sheh sektorin e energjisë si pengesë serioze për zhvillimin ekonomik për shkak të mungesës së investimeve të reja, revitalizimit të pamjaftueshëm të KEK-ut, varësisë nga importi dhe shkallës së ulët të ndërtimit të kapaciteteve të energjisë së ripërtëritshme.

Kjo diagnozë përputhet me një pjesë të realitetit të raportuar nga ZRRE: kërkesa është rritur, Kosova vazhdon të jetë neto importuese, importi është rritur ndjeshëm dhe prodhimi vendor është kufizuar nga vjetërsia dhe mirëmbajtja e njësisë ekzistuese. Prandaj, AAK e identifikon saktë problemin e kapaciteteve dhe nevojën për investime.

ÇKA MUNGON

Programi mbetet më shumë diagnozë sesa paketë e kostuar politike. Ai nuk e sqaron mjaftueshëm se cilat kapacitete të reja do të ndërtohen, me çfarë teknologjie, me çfarë modeli financiar, me çfarë ndikimi në tarifa dhe me çfarë përputhshmërie me detyrimet e Kosovës për klimën dhe tregun evropian. Nëse nënkuptohet rikthim te projekte të mëdha termike, atëherë duhet të sqarohet kostoja e karbonit, standardet mjedisore dhe ndikimi i CBAM-it. Nëse nënkuptohet orientim drejt gazit ose BRE-ve, duhet të jepen instrumentet: ankandet, garancitë, rrjeti, bateritë, eficiencia dhe skemat sociale.

Programet/qëndrimet publike mbulojnë gjysmën e problemit. Tjetra mbetet boshllëk politik.

E PËRBASHKËTA

- 01 Siguria e furnizimit si prioritet i të gjitha partive të mëdha.
- 02 Rehabilitim i Kosova B si pjesë e tranzicionit afatmesëm.
- 03 BRE të pranishme në pothuajse çdo ofertë — me nivele të ndryshme detajimi.
- 04 Ulje fature përmes TVSH-së ose subvencioneve (politikisht e kuptueshme, jo e mjaftueshme).
- 05 Efiçencë e përmendur — por jo trajtuar si kapacitet virtual i sistemit.

BOSHLLËQET KRYESORE

Kostoja e plotë e sistemit

Programet fokusohen te kapacitetet energjetike, por jo mjaftueshëm te kostoja totale e sistemit, përfshirë rrjetin, balancimin, importin dhe ndikimin në tarifa. Në energji, vlera e një megavati varet nga fleksibiliteti, kostot, emetimet dhe investimet shtesë që kërkon sistemi.

Çmimi i karbonit dhe CBAM-i

Nga viti 2026, CBAM-i e bën karbonin çështje ekonomike dhe financiare edhe për eksportet e energjisë drejt BE-së. Megjithatë, programet nuk sqarojnë si do ta menaxhojë Kosova këtë realitet, përfshirë çmimin e karbonit, mbrojtjen e familjeve të cenueshme dhe ruajtjen e konkurrueshmërisë së industrisë vendore.

Varfëria energjetike

Programet përmendin përballueshmërinë dhe mbrojtjen sociale, por nuk ofrojnë zgjidhje të plotë për varfërinë energjetike. Kosovës i nevojitet përkufizim ligjor, mbështetje e targetuar për konsumatorët e cenueshëm dhe programe të efiçencës për familjet me të ardhura të ulëta.

Fleksibiliteti i sistemit

Rritja e energjisë solare dhe të erës kërkon bateri, rezerva, treg balancues, menaxhim të kërkesës dhe digjitalizim të rrjetit. Këto elemente janë të pranishme vetëm pjesërisht në disa programe. Pa to, BRE-të mund të rriten në kapacitet të instaluar, por jo domosdoshmërisht në vlerë të plotë për sistemin.

Rrjeti dhe humbjet

Humbjet në shpërndarje mbeten problem strukturor. Në vitin 2025 ato ishin 995 GWh, ose 15.05% ndaj kërkesës në shpërndarje. Ulja e humbjeve duhet të jetë prioritet kombëtar. Ajo kërkon investime në rrjet, kontroll më të mirë, matje inteligjente, qeverisje të operatorit dhe rregullim të qartë nga ZRRE.

Ngrohja qendrore si politikë kombëtare

Ngrohja qendrore duhet parë si instrument për uljen e konsumit dimëror, varfërisë energjetike dhe ndotjes, jo vetëm si projekt komunal. Edhe pse disa programe e trajtojnë këtë çështje, ende mungon një plan kombëtar i financuar dhe i fazuar.

Qeverisja e sektorit

Pak flitet për transparencën e tarifave, konsultimet publike, rolin e ZRRE-së, monitorimin e investimeve, performancën e operatorëve, të dhënat e hapura dhe mbrojtjen e konsumatorit në procesin e liberalizimit. Pa qeverisje të mirë, edhe projektet teknikisht të mira mund të kthehen në kosto të larta dhe rezultate të dobëta.

Tranzicioni i drejtë për rajonet e linjtit

Nëse Kosova synon dekarbonizim gradual, duhet të ketë plan për Obiliqin, KEK-un, punëtorët, zinxhirin lokal ekonomik dhe komunat që varen nga ekonomia e linjtit. Kjo temë mungon në mënyrë të dukshme. Tranzicioni nuk mund të jetë vetëm ndryshim teknologjije; duhet të jetë edhe politikë sociale, lokale dhe industriale.

Sektori do të hyjë në një fazë me tri drejtime që do të zhvillohen paralel.

DREJTIMI 01

Gara për kapacitete të reja

Varësisht nga përbërja qeverisëse, kjo mund të marrë formën e termocentralit të ri me linjit, centralit me gaz, rehabilitimit të thellë të Kosova A dhe Kosova B, ose përshejtimit të burimeve të ripërtëritshme. Çdo opsion ka kosto, afate dhe rreziqe të ndryshme. Prandaj, vendimmarrja duhet të bazohet në analiza të pavarura të sistemit, jo në intuitë politike.

DREJTIMI 02

Presioni mbi faturën

Rritja e tarifave në vitin 2025 tregoi se sistemi nuk mund t'i absorbojë pafund kostot pa reflektim te konsumatori. Çdo investim i madh, qoftë në rrjet, prodhim, import, rehabilitim apo rezervë, do të kërkojë burim financimi. Në mungesë të skemave të targetuara, kjo mund të godasë më shumë familjet me të ardhura të ulëta.


DREJTIMI 03

Evropianizimi i detyruar

CBAM-i, integrimi i tregut, ALPEX-i, garancitë e origjinës, ankandet e BRE-ve, efiçienca në ndërtesa dhe objektivat klimatike nuk janë më çështje dytësore. Ato janë kushte për tregti, investime dhe përafrim me BE-në.

TREKËNDËSHI PAPËRFUNDUAR

Asnjë ofertë politike nuk e mbyll plotësisht atë.



CIKËL I RI TREGU

Energjia do të jetë gjithnjë e më pak çështje administrative dhe gjithnjë e më shumë çështje konkurrueshmërie, karboni dhe integrimi.

Nga premtime për projekte të veçanta — drejt një pakete të integruar reformash.

Qeveria e ardhshme, pavarësisht përbërjes politike, duhet ta trajtojë energjinë si agjendë të matshme kombëtare — të lidhur njëkohësisht me sigurinë e furnizimit, përbalueshmërinë, konkurrueshmërinë dhe detyrimet ndaj tregut evropian.

- 01 Analizë e pavarur e skenarëve të gjenerimit — krahasim linjit/gaz/BRE/bateri/import/efiçencë/ngrohje qendrore mbi bazë të kostos së plotë të sistemit.
- 02 Modernizim i njësive aktuale vetëm mbi bazë të kriterëve të qarta teknike, mjedisore dhe ekonomike — të lidhura me plan gradual të tranzicionit.
- 03 Kosto e karbonit në çdo analizë të kapaciteteve të reja — përfshirë CBAM-in, obligimet ndaj Komunitetit të Energjisë dhe rrezikun e aseteve të bllokuara.
- 04 Decentralizim i prodhimit — prosumerë, komunitete energjie, ndërmarrje lokale, kooperativa, biznese prodhuese dhe institucione publike.
- 05 Lehtësim procedurash për investime të vogla dhe të mesme në BRE dhe efiçencë — autorizime, kyçje në rrjet, vetë-konsum, financa, kompensim.
- 06 Program Kombëtar i Efiçencës me buxhet minimal 500 mln € / 4 vite — ndërtesa banimi, publike, shkolla, spitale, familje në varfëri energjetike.
- 07 Fuqizim i Fondit të Kosovës për Efiçencë — grante, kredi të buta, garanci, pagesë për kursim, skema të bazuara në performancë.
- 08 Masa fiskale të dedikuara për efiçencë dhe energji të pastër — të hyrat klimatike të dedikohen për konsumatorët e cenueshëm.
- 09 Përkufizim ligjor i varfërisë energjetike + regjistër i konsumatorëve të cenueshëm: të ardhura, konsum, banesë, familje, status social.
- 10 Zëvendësim gradual i subvencioneve horizontale me mbështetje të targetuar për ata që mbajnë barrë reale energjetike.

- 11 Bazë kombëtare e të dhënave për konsumin e energjisë — stok ndërtesash, performancë, ngrohje, status social.
- 12 Përfundim i projekteve të ngrohjes qendrore për komunat me studime fizibiliteti — afate, financim, prioritizim.
- 13 Pesë sisteme të reja shtesë të ngrohjes qendrore, përtej projekteve që kanë kaluar fazën e fizibilitetit.
- 14 Përshpejtim i ankandeve për BRE — me plan paralel për bateri, fleksibilitet, rezerva dhe përforsim të rrjetit.
- 15 Kapacitete ruajtëse të decentralizuara — bateri komunale, industriale, komerciale, familjare.
- 16 Digjitalizim i rrjetit dhe instalim gradual i matësve inteligjentë — për menaxhim kërkesë dhe shërbime të reja energjetike.
- 17 Program i ri i liberalizimit të tregut — afate të qarta, kritere të parashikueshme, masa mbrojtëse për konsumatorët.
- 18 Integrim me tregun rajonal — ALPEX, treg balancues, kapacitete ndërkufitare, garancitë e origjinës, rregullat evropiane.
- 19 Decentralizim i shërbimeve energjetike — këshillim komunal, zyra për eficiencë, mbështetje për prosumerë e ndërtesa shumëbanesore.
- 20 Transparencë në proceset tarifore — të dhëna për koston, humbjet, investimet, cilësinë, ankesat.
- 21 Mekanizëm i rregullt konsultimi mes institucioneve, ZRRE-së, operatorëve, komunave, shoqërisë civile, biznesit, ekspertëve të pavarur.

VIZIONI I INDEP

Nga logjika e projekteve të izoluar — drejt një sistemi të integruar.

PRODHIM më i
decentralizuar

RRJET
më inteligjent

KONSUM
më efikas

NGROHJE
më e pastër

TREG
më funksional

MBROJTJE
më e saktë sociale

[1] Programet dhe qëndrimet publike të subjekteve politike të analizuar: zotimet e VV-së për 7 qershor 2026; programet/qëndrimet e disponueshme për PDK, LDK dhe AAK.

[2] ZRRE, Raporti Vjetor 2025 — të dhënat për prodhimin, kërkesën, importin dhe eksportin.

[3] ZRRE, Raporti Vjetor 2025 — të dhënat për humbjet në shpërndarje.

[4] ZRRE, Raporti Vjetor 2025 — të dhënat për rritjen e tarifave dhe çmimet mesatare.

[5] ZRRE, Raporti Vjetor 2025 — pjesa për liberalizimin e tregut, Garancitë e Origjinës dhe mekanizmin mbështetës për BRE.

[6] Zotimet e VV-së, kapitulli "Energjia dhe Minierat".

[7] Zotimet e VV-së për investime në Kosova A dhe Kosova B.

[8] Zotimet e VV-së për kapacitete të erës, solare dhe neto eksport.

[9] Zotimet e VV-së për ngrohje qendrore dhe eficiencë.

[10] Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022–2031 dhe draft-NECP-i.

[11] Programi i PDK-së për energjinë dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

[12] Programi i PDK-së për "Kosova e Re", minierën e re të linjitit dhe revitalizimin e Kosova B.

[13] Qëndrimet e LDK-së për centralin me gaz 500 MW dhe gazifikimin.

[14] Qëndrimet/programi i LDK-së për centralin me gaz 500 MW dhe gazifikimin.

Përmbajtja e këtij punimi është përgjegjësi vetëm e Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Heinrich Böll Stiftung (HBS).
